



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1144 / 14 prot.

Tiranë më 11.10.2021

REKOMANDIM

Nr. 50, datë 11.10.2021

PËR KONTROLLUESIN “SMART COLLECTION SHPK”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Smart Collection SHPK”,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 125, datë 23.08.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një shtetase, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale dhe zbatimi i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Smart Collection SHPK është një shoqëri e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj: “Mbledhjen e detyrimeve të prapambetura dhe kredive të këqija për bankat e nivelit

të dytë dhe të tretë. Rikuperimin e detyrimeve të prapambetura që kanë institucionet shtetërore, kompanitë private, etj.

2. Në kuadër të trajtimit të ankesës, nga verifikimi i kryer rezulton se, shoqëria “*Fed Invest SHKK*” (në cilësinë e kontrolluesit) më datë 27.12.2019, ka vënë në dispozicion të “*Smart Collection SHPK*” (në cilësinë e përpunuesit), të dhënat e debitorëve ndër të tjera edhe të dhënat e dorëzanesës (ankueses) në format elektronik (dokument Excel me titull “*Info Smart Collections 2nd portofolio (ok)*”). Në marrëveshjen me “*Fed Invest SHKK*”, pika 2.1, të nenit 2, parashikohen detyrimet e “*Smart Collection SHPK*”, për të kontaktuar klientët për të cilët është autorizuar, sipas të dhënave të vëna në dispozicion, në zbatim të marrëveshjes.

Në deklaratën e dorëzansës, të dhënat e përpunuara janë: emër, atësi, mbiemër (vajzërie), numri i identitetit të dorëzanesës (është i pasaktë referuar kartës së identitetit) dhe gjithashtu konstatohet se nuk janë vënë në dispozicion të dhëna në lidhje me kontaktin telefonik, email, adresë fizike banese dhe/ose pune. Referuar të dhënave të garantorëve, të vëna në dispozicion nga “*Fed Invest SHKK*” për “*Smart Collections SHPK*” (në cilësinë e përpunuesit), konstatohet se të dhënat sipas tabelës së nisur me email konsistojnë në kategoritë: nr. kontrate, emër, mbiemër, atësi, datëlindje, ID, telefon, adresë banimi dhe qyteti ku banon.

Gjatë hetimit administrativ, përfaqësuesi i “*Smart Collection SHPK*” ka deklaruar se me qëllim të rivendosjes së komunikimit me dorëzanesën, kemi shkuar në banesën e saj. Në banesë janë pritur nga babai i bashkëshortit të saj pasi ajo nuk ishte e pranishme. Mbasi është prezantuar se cilën shoqëri përfaqëson, përfaqësuesi ka kërkuar të takohet me ankuesen. Babai i bashkëshortit të saj ka kërkuar më tepër informacion, por i është vënë në dispozicion vetëm numri i telefonit për tu kontaktuar nga dorëzansësja. Mbas disa ditësh, babai i bashkëshortit të saj ka kontaktuar me Smart Collections SHPK dhe ka thënë se është në dijeni të pozicionit të garantorit të nuses së djalit në një kredi, dhe ka kërkuar që “*Smart Collections SHPK*” të mos i shqetësonte më në familje.

Nga hetimi administrativ i ushtruar nuk është konstatuar të jetë kryer përpunim i paligjshëm të dhënash dhe/ose përhapje të dhënash personale drejt personave të paautorizuar.

3. Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale gjatë ushtrimit të veprimtarisë, në kuadër të ushtrimit të aktivitetit të vet “*Smart Collection SHPK*” ka lidhur “*Marrëveshje bashkëpunimi*” me “*Fed Invest SHKK*”, me objekt “*... trajtimin dhe mbledhjen e detyrimeve të prapambetura të debitorëve të Fed Invest SHKK... të lindura nga kontratat respektive të huas, të lidhura midis palëve.*”. Në këtë marrëveshje nuk janë parashikuar detyrimet e Kontrolluesit dhe Përpunuesit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 20 të ligjit si dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012, mbi “*Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit*

dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit, si dhe hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se kontrolluesi “*Smart Collection SHPK*” nuk ka “*Njoftuar*” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Në pikën 1, të nenit 21 të ligjit, parashikohet se njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit të njoftuar më parë.

“*Smart Collection SHPK*”, sipas ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit është krijuar dhe ushtron veprimtarinë e saj që prej datës 22.06.2018.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i rezervojnë shprehimisht dispozitat e Ligjit.

5. “*Smart Collection SHPK*” nuk disponon rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale për të gjitha proceset përpunuese*” (përpunimin e të dhënave personale të klientëve, punonjësve etj.), në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ, hartoi procesverbalin përkatës një kopje e të cilit e vendosi në dispozicion të kontrolluesit. Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i kontrolluesit ka paraqitur pretendimet me shkrim si vijon:

- Sa i përket konstatimit në procesverbal se në kontratën me Fed Invest SHKK, mungojnë parashikimet sipas nenit 20 të ligjit, Smart Collection SHPK argumenton se ky konstatim nuk është i drejtë, për arsye se të dhënat e huamarrësve janë marrë nga Fed Invest SHKK, në përputhje me parashikimet e nenit 6 të ligjit si dhe përcaktimet në formularin e firmosur nga kredi marrësit/dorëzanësi, për qëllimin për të cilin do të përdoren këto të dhëna. Kontrata e lidhur midis Fed Invest SHKK dhe Smart Collection SHPK ka për qëllim rikuperimin e marrëdhënies së kontratës së huas të lidhur me klientët. Smart Collection autorizohet për të kontaktuar huamarrësit për të vendosur në kushte normale zbatimin e kontratës së huas dhe nuk janë përdorur për asnjë qëllim tjetër.

Zyra e Komisionerit vlerëson se “*Marrëveshja bashkëpunimi*” e lidhur midis palëve, ka të parashikuara disa detyrime mbi mënyrën e veprimit për kontaktimin e klientëve nga Smart Collection SHPK (në cilësinë e përpunuesit), por ky akt nuk parashikon detyrimet sipas parashikimeve në pikën 1 të nenit 20 të ligjit dhe Udhëzimit nr.19, të cilat duhet të përcaktohen në kontratën e shkruar të kontrolluesit me përpunuesin.

- Sa i përket konstatimeve të tjera, nga Smart Collection SHPK nuk ka pretendime.

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimit të tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe eviton mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 20, 21, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/l”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Smart Collection SHPK, në cilësinë e përpunuesit, të ketë në vëmendje zbatimin e detyrimeve sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të miratuar nga Komisioneri;
2. Smart Collection SHPK, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të kryejë pranë Zyrës së Komisionerit, “*Njoftimin*” mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës;
3. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të marrë masa për hartimin e rregullores “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative sipas parashikimeve të nenit 27 të ligjit.
4. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:

- Brenda 30 ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1 dhe 3 më sipër.
- brenda 15 ditëve, detyrimin e treguar në pikën 2 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

5. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra.

Në rast mos përmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2 të nenit 30 dhe nenit 39 të ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më 11.10.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

